



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Nr. 182 prot.

Tiranë, më 31.10 2020

URDHËR
Nr. 91, datë 31.10 2020

PËR

“NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS LIDHUR ME MUNDËSINË E VOTIMIT
NGA JASHTË VENDIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN 25 PRILL 2021”

Bazuar në nenin 19 pika 2, nenin 24 dhe 25 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

Urdhëroj:

Ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin e mundësisë për votimin nga jashtë vendit, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ,në Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, me përbërje si më poshtë:

1. Ylli MERKAJ, Sekretar i Përgjithshëm - Kryetar
2. Nexhmi MEZANI, Drejtor, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit- Anëtar
3. Ana TENOLLI , Drejtore, Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore- Anëtar
4. Mirela GEGA, Drejtore, Drejtoria e Financës- Anëtar
5. Erion META, Shef i dekriminalizimit, Drejtoria Juridike - Anëtar
6. Anduela NDREU, Shef i edukimit- Anëtar

Grupi i punës ka këto detyra:

1. Të vlerësojë mundësinë e votimit nga jashtë vendit, në Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021 të shtetasve shqiptar me të drejtë vote, të cilët e kanë rezidencën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Të përgatisë një vlerësim mbi llojin, procedurën e votimit, manuale ose elektronike, duke marrë në konsideratë kushtet e vendit tonë.



3. Të përgatisë një vlerësim mbi procesin e votimit dhe administrimin e votave dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e zgjedhjeve.
4. Të bëjë një vlerësim të përgjithshëm mbi kostot financiare.
5. Të përgatisë një listë me akte juridike dhe protokolle teknike që do të bëjnë të mundur votim nga jashtë vendit.
6. Të prezantojnë modele të këtij lloj votimi në vende të ndryshme.

Në përfundim grupi i punës përgatit një raport, të cilin ja dorëzon Komisionerit.

Afati i dorëzimit të këtij raporti është data 15 nëntor, 2020.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

